

Martesa

Martesa midis dy shtetasve shqiptarë

Baza Ligjore:

- Neni 46, 47, 48, 49, 50 të Ligjit Nr.10129, datë 11.05.2009 “Për Gjendjen Civile”

- Ligji Nr.9062 datë 08.05.2003 Kodi i Familjes

Martesa mund të lidhet ndërmjet një burri dhe gruaje që kanë mbushur moshën 18 vjeç. Përpara lidhjes së martesës, nëpunësi i gjendjes civile bën shpalljen e saj dhe afishimin në vende të caktuara nga bashkia. Kërkesa për shpallje bëhet nga bashkëshortët e ardhshëm ose nga personi i caktuar nga ata me prokurë të posaçme. Shpallja duhet të bëhet në zyrën e gjendjes civile të vendbanimit të nuses dhe dhëndrit kurse lidhja e martesës (celebrimi) mund të bëhet në Zyrën e Gjendjes Civile të vendbanimit të njërit prej tyre. Nëse nuk kanë jetuar 6 muaj në vendbanimin ose vendqëndrimin aktual, shpallja duhet të bëhet edhe në bashkinë ku bashkëshorti ka jetuar më parë.

Personi që kërkon shpalljen duhet t'i paraqesë nëpunësit të gjendjes civile certifikatat e lindjes së të dy bashkëshortëve të ardhshëm me shënimin “Shpallje martese”, fotokopjet e letërnjoftimeve, si dhe çdo dokument tjetër që është i nevojshëm dhe provon se nuk ekzistojnë pengesa për lidhjen e martesës. Martesa nuk mund të lidhet para se të kalojnë 10 ditë nga e nesërmja e shpalljes. Afati i lidhjes së martesës është deri 1 vit nga dita e shpalljes së martesës.

Për Lidhjen e martesës bashkëshortët e ardhshëm duhet të paraqesin në zyrën e gjendjes civile certifikatat e lindjes me shënimin “Lidhje martese”. Akti i martesës nënshkruhet në prani të jo më pak se dy dëshmitarëve.

Certifikatat për shpallje dhe lidhje martese kanë vlefshmëri brenda 15 ditëve nga data e lëshimit.

Taksa për mbajtjen e aktit të Lidhjes së martesës është 1.000 lekë. Kjo taksë paguhet në zyrën e gjendjes civile.

Për informacione të mëtejshme drejtoheni pranë Zyrës së Gjendjes Civile ose pranë Sportelit të Informacionit.

Martesa midis një shtetasi shqiptar dhe një të huaj

Baza Ligjore:

- Neni 46, 47, 48, 49, 50 të Ligjit Nr.10129, datë 11.05.2009 “Për Gjendjen Civile”

- Ligji Nr.9062 datë 08.05.2003 Kodi i Familjes

Martesa mund të lidhet ndërmjet një burri dhe gruaje që kanë mbushur moshën 18 vjeç. Përpara lidhjes së martesës, nëpunësi i gjendjes civile bën shpalljen e saj dhe afishimin në vende të caktuara nga bashkia. Kërkesa për shpallje bëhet nga bashkëshortët e ardhshëm ose nga personi i caktuar nga ata me prokurë të posaçme. Shpallja duhet të bëhet në zyrën e gjendjes civile të vendbanimit të nuses dhe dhëndrit kurse lidhja e martesës (celebrimi) mund të bëhet në Zyrën e Gjendjes Civile të vendbanimit të njërit prej tyre. Nëse nuk kanë jetuar 6 muaj në vendbanimin ose vendqëndrimin aktual, shpallja duhet të bëhet edhe në bashkinë ku bashkëshorti ka jetuar më parë.

Personi që kërkon shpalljen duhet t'i paraqesë nëpunësit të gjendjes civile këto dokumente për shtetasin e huaj:

- çertifikatë lindje (ky dokument duhet të ketë shënimin “jepet për shpallje apo publikim martese në Shqipëri”)
- çertifikatë familjare (në rastet kur emrat e prindërve nuk janë të shënuar në çertifikatën e lindjes)
- çertifikatë ku të cilësohet statusi i gjendjes civile dhe shtetësia e personit që do martohet.
- Dokument që cilëson vendbanimin.
- çdo dokument që është i nevojshëm dhe provon se nuk ekzistojnë pengesa për lidhjen e martesës.
- Fotokopje të kartës së identitetit ose pasaportës

Martesa nuk mund të lidhet para se të kalojnë 10 ditë nga e nesërmja e shpalljes. Për Lidhjen e martesës bashkëshorti i ardhshëm duhet të paraqesë në zyrën e gjendjes civile çertifikatën me shënimin “Lidhje martese” në Shqipëri me shtetasin/ shtetasen ----- . Çdo dokument që dorëzohet në zyrën e gjendjes civile duhet të jetë origjinal dhe i legalizuar në përfaqësitë diplomatike/ konsullore shqiptare në shtetin përkatës, ose me vulën APOSTILE. Në Shqipëri përkthehen (nga përkthyes të licencuar nga Ministria e Drejtësisë) dhe noterizohen. Dokumentet që dorëzohen për shpallje apo lidhje martese kanë vlefshmëri 3 muaj nga data e lëshimit. Në rastet kur ky afat është i ndryshëm, duhet të cilësohet në dokument.

Akti i martesës nënshkruhet në prani të jo më pak se dy dëshmitarëve. Taksa për mbajtjen e aktit të Lidhjes së martesës është 1000 lekë. Kjo taksë paguhet në zyrën e gjendjes civile.

Për informacione të mëtejshme drejtoheni pranë Zyrës së Gjendjes Civile ose pranë Sportelit të Informacionit.